Provimi 1 11 maj 2011 A

Kontabiliteti financiar II

Pjesa I: Pyetje me zgjidhje shumëfishe, vetëm njëra nga përgjigjet është e saktë. Secila përgjigje e saktë 2.5 pikë (gjithsej 25 pikë)

1. Cila nga elementet më poshtë do të RRITË vlerën e ardhshme në relacion me vlerën e tanishme?
   a. norma më e lartë e interesit
   b. periudha më e shkurtër
   c. siguri më e madhe
   d. më pak rrezik

2. Një vjetore është një seri e
   a. shumave të barabarta të paguara ose të pranuara brenda një numri të caktuar të periudhave jo të barabarta
   b. shuma jo të barabarta të pagaura ose të pranuara Brenda një numri të caktuar të periudhave të barabarta
   c. shumave të barabarta të paguara ose të pranuara brenda një numri të pacaktuar të periudhave të barabarta
   d. shumave të barabarta të paguara ose të pranuara brenda një numri të caktuar të periudhave të barabarta

3. Një bono me interes 10% shitet me një çmim që do të rezultoj interes efektiv prej 9%. Prandaj, mund të përfundojmë se çmimi me të cilin është shitur bono është
   a. më i lartë se vlera e shkruar në bono
   b. më i ulët se vlera e shkruar në bono
   c. e barabartë me vleërën e shkruar në bono
   d. nuk mund të përcaktohet nga informatat e mësipërme

4. Cili në vijim është numri i aksioneve që aktualisht kanë në dorë aksionarët?
   a. aksionet e shpërndara
   b. aksionet e emetuara
   c. aksionet e autorizuara
   d. aksionet e dërguara

5. Kompania SuperRam ka gjithsej detyrime prej €50,000, gjithsej asete prej €280,000 dhe kapital të kontribuuar prej €120,000. Cila është shuma e fitimeve të mbajtura?
   a. €20,000
   b. €110,000
   c. €140,000
   d. €160,000

6. Dividendat që paguhen me aksione të zakonshme janë
   a. shpenzime kur paguhen
   b. shpenzime kur ndodhin
   c. shpenzohen në fund të vitit
   d. zvogëlim në fitimet e mbajtura

7. Cila nga elementet në vijim NUK ndikon në strukturën e kapitalit të kompanisë?
   a. llogaritë e pagueshme
   b. paraja
   c. bono e pagueshme
   d. kapitali i paguar

8. Leverazhi financiar rezulton me
   a. rritjen e likuiditetit
   b. rritje të kthimit në ekuitet
   c. zvogëlim të rrezikut
   d. kthim më jostabil në ekuitet

9. Formatet direkte dhe indirekte janë mentoda të përgatitjes së
   a. seksionit të aktiviteteve operative të pasqyrës së rrjedhës së parasë
   b. seksionit të aktiviteteve investuese të pasqyrës së rrjedhës së parasë
   c. pasqyrës së të ardhurave
   d. bilancit të gjendjes

10. Cila nga elementet në vijim ka efekt të ndryshëm mbi fitimin neto kundrejt efektit që ka në rrjedhën e parasë?
   a. pagesa e pagave
   b. shitja me para ndaj konsumatorëve
   c. amortizimi i patentave
   d. pagesa e qirasë

Pjesa II Detyra (75 pikë)

1. **(20 pikë)** Kompania Bora ka emetuar bono në vlerë prej €100,000 që maturohen për 15 vjet me 8% interes me 1 janar 2004. Bonot paguajnë interes vjetor dhe janë shitur për 109.10% për të fituar interes prej 7%.

a. Sa duhet të njihet interes në bono për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2005?
b. Cilën shumë të detyrimeve neto duhet të raportoj kompania me 31 dhjetor 2006 në bilancin e gjendjes?
c. Cila shumë nga pagesa e vitit 2006 do të jetë interesi?

Ndihmë: për të llogaritur shumat do të ju ndihmonte një tabelë e amortizimit!

Bazuar në tabelën e amortizimi më poshtë:

a. €7,612
b. €107,945
c. €7,585

Vitet	Vlera në fillim të vitit	Interesi i ndodhur	Shuma e paguar	Amortizimi i kryegjësë	Vlera në fund të vitit
2004	109,110	7,638	8,000	362	108,748
2005	108,748	7,612	8,000	388	108,360
2006	108,360	7,585	8,000	415	107,945

2. **(10 pikë)** Kompania Sinergjia ka blerë një pajisje sipas një plani të pagesave afatgjata. Kontrata kërkon nga kompania të paguaj nga €30,000 në fund të secilit vit për 7 vite me rradhë, me një interes prej 6%. Sipas cilës shumë duhet të regjistrojë kompania këtë pajisje dhe cila do të jetë shuma totale e interesit që duhet të paguhet për 7 vjet?

Shuma që do të regjistrohet = €167,471.40 (€30,000 x 5.58238)
Totali i interesit të paguar = €42,528.60 (€210,000 - €167,471.40)

3. **(15 pikë)** Kompania Leti raportoj informatat financiare të selektuara:

Gjithsej asete	€2,000
Gjithsej detyrime	500
Fitime të mbajtura	1,000
Shitje (të hyra)	3,600
Fitimi neto	900

Kërkohet:

a. Llogaritni kthimin në asete.
b. Llogaritni kthimin në ekuitet.
c. Shpjegoni rolin e leverazhit financiar në rezultatet e pjesës (a) dhe (b).

a.

ROA = Fitimi neto ÷ Gjithsej asetet
= €900 ÷ €2,000
= 0.45

b.

ROE = Fitimi neto ÷ Ekuiteti i aksionarëve
= €900 ÷ €1,500
= 0.60

c. Leverazhi financiar mund të rritë kthimin në ekuitet. Për shkak të leverazhit financiar, kthimi në asete prej 45% është 'ngritur' në masë të kthimit në ekuitet prej 60%.

4. **(30 pikë)** Inforatat të përzgjedhura janë raportuar nga kompania Ciceroni:

Në vitin që përfundon me 31 dhjetor 2010

Të hyrat nga shitja	€500,000
Kosto e mallit të shitur	250,000
Shpenzime operative	136,000
Fitimi neto	114,000
Dividenda të paguara	50,000

Me 31 dhjetor	2010	2009
Paraja	€16,000	€ 28,000
Llogari të arkëtueshme	40,000	30,000
Stoqet	28,000	36,000
Llogaritë e pagueshme	30,000	34,000
Paga të pagueshme	18,000	10,000

Kërkohët:

Shpenzimet operative përfshijnë shpenzimin e zhvlerësimit prej €14,000. Përcaktini rrjedhën e parasë nga aktivitetet operative për vitin, duke përdorur formatin indirekt.

Fitimi neto	€114,000
E korrigjuar me:	
Rritja e llogarive të arkëtueshme	(10,000)
Zvogëlimi në stoqe	8,000
Zvogëlimi në llogari të pagueshme	(4,000)
Rritja në pagat e pagueshme	8,000
Shpenzimi i zhvlerësimit	14,000
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	€130,000

Tabela 1: Vlera e tanishme e 1$ që do të paguhet në të ardhmen

Vitet	1%	2%	3%	4%	5%	6%	7%	8%	9%	10%
1	0.9901	0.9804	0.9709	0.9615	0.9524	0.9434	0.9346	0.9259	0.9174	0.9091
2	0.9803	0.9612	0.9426	0.9246	0.9070	0.8900	0.8734	0.8573	0.8417	0.8264
3	0.9706	0.9423	0.9151	0.8890	0.8638	0.8396	0.8163	0.7938	0.7722	0.7513
4	0.9610	0.9238	0.8885	0.8548	0.8227	0.7921	0.7629	0.7350	0.7084	0.6830
5	0.9515	0.9057	0.8626	0.8219	0.7835	0.7473	0.7130	0.6806	0.6499	0.6209
6	0.9420	0.8880	0.8375	0.7903	0.7462	0.7050	0.6663	0.6302	0.5963	0.5645
7	0.9327	0.8706	0.8131	0.7599	0.7107	0.6651	0.6227	0.5835	0.5470	0.5132
8	0.9235	0.8535	0.7894	0.7307	0.6768	0.6274	0.5820	0.5403	0.5019	0.4665
9	0.9143	0.8368	0.7664	0.7026	0.6446	0.5919	0.5439	0.5002	0.4604	0.4241
10	0.9053	0.8203	0.7441	0.6756	0.6139	0.5584	0.5083	0.4632	0.4224	0.3855

Tabela - 2: Vlera e tanishme e 1$ për periudhë që do të paguhet në fund të secilës periudhë

Vitet	3%	4%	5%	6%	7%	8%	9%	10%
1	0.9709	0.9615	0.9524	0.9434	0.9346	0.9259	0.9174	0.9091
2	1.9135	1.8861	1.8594	1.8334	1.8080	1.7833	1.7591	1.7355
3	2.8286	2.7751	2.7232	2.6730	2.6243	2.5771	2.5313	2.4869
4	3.7171	3.6299	3.5460	3.4651	3.3872	3.3121	3.2397	3.1699
5	4.5797	4.4518	4.3295	4.2124	4.1002	3.9927	3.8897	3.7908
6	5.4172	5.2421	5.0757	4.9173	4.7665	4.6229	4.4859	4.3553
7	6.2303	6.0021	5.7864	5.5824	5.3893	5.2064	5.0330	4.8684
8	7.0197	6.7327	6.4632	6.2098	5.9713	5.7466	5.5348	5.3349
9	7.7861	7.4353	7.1078	6.8017	6.5152	6.2469	5.9952	5.7590
10	8.5302	8.1109	7.7217	7.3601	7.0236	6.7101	6.4177	6.1446